



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 518/ 2010

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerit Kujtim Bojaj dhe drejtorit të shkollës “Ismet Raci” komuna Kline, Gani Ahmet-Xhekaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me nr. A-518, e datës 13.12.2010 e subjektit politik Fryma e Re.

#### Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një (1) ankesë, me numër A-518 të paraqitur nga FER në të cilën pretendohet se “më datë 12.12. 2010 rreth orës 16:35, në QV0801/08R, në shkollën “Ismet Rraci” një qytetar me emrin Ardian Krasniqi nuk është lejuar të votoj për shkak se ka pasur si dokument identifikues vetem një letër. Më pas i njëjti person ka intervenuar tek drejtori i shkollës Gani Ahmetgjekaj për të ia mundësuar komisionari Kujtim Bojaj për të votuar.

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtresuesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parasheh si vijon:

*3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik FER, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 518/2010 më datën 15.12.2010.

